


KISCOMS

INTERNATIONAL CONGRESS OF MEDICAL SCIENCES

6-7 May, 2017
Swiss Diamond Hotel
Prishtina, Republic of Kosovo

ABSTRACT BOOK FINAL PROGRAM



“Morbiditeti dhe ndotja e ajrit në rajonin e Shkupit për vitin 2015 të fëmijët e moshave shkollore dhe parashkollore”

M. Gjetaj-Jakovski¹, Sh. Musa¹, V. Dobrosavleviq¹, P. Simjanoski¹, L. Kostadinovski¹, R. Pejčinovska², L. Bajrami¹, L. Imeri¹/ ¹Qendra për Shëndet Publik – Shkup, R. e Maqedonisë

Hyrje: Është vërtetuar se tre million njerëz vdesin çdo vit nga ndotja e ajrit, që tregon se roli i koncentrimëve ditore të substancave të cilat fundërrrojnë në ajrin ambiental si pasojë e burimeve të ndryshme të ndotjes si: emisioni, imisioni transmisioni, sjellin deri te lajmërimi i sëmundjeve respiratore jospecifike, kardiovaskulare etj.

Qëllimi: Zvogëlimi i numrit të fëmijëve të sëmurë nga mosha parashkollore dhe shkollore prej sëmundjeve respiratore jospecifike në bazë të monitorimit të kryer për cilësinë e ajrit ambientorë.

Materiali dhe metoda: Të dhënat janë të fituara nga Raporti vjetor që përgatitet për realizim të programit vjetorë kombëtarë për shëndet publik për vitin 2015 pranë Qendrës për Shëndet Publik në Shkup, ku përcillet morbiditeti sezonal nga sëmundjet respiratore jospecifike te fëmijët parashkollorë (0 -6) dhe shkollorë (7-14), në veçanti për qytet dhe për fshat sipas shifrave J00-J99 (sëmundje respiratore jospecifike) me përjashtim të J10-J18 (influenca dhe pneumonia), nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve (KNS-10).

Rezultate: Nga evaluimi i të dhënave mund të konstatohet se më pak sëmuren fëmijët nga fshati në raport me fëmijët nga qyteti, si dhe ekzistimi i variacionit ciklik sezonal të morbiditetit.

Përfundim: Vlerësimi i rrezikut nga cilësia higjienike e ajrit mbi shëndetin e

popullatës së ekspozuar, konkretisht fëmijët parashkollorë dhe shkollorë, bëhet në bazë të të dhënave të fituara nga monitoringu që na tregon se shkalla e ndotjes së ajrit në qytet është më e lartë se sa në fshat. Patjetër është e nevojshme të përcillet cilësia e ajrit përmes monitorimit, matjeve kontinuale në pikat matëse dhe marrja e mostrave për përcaktimin e koncentrimit të substancës kontaminuese në ajër.

Fjalë kyçe: Morbiditet, fëmijë, ajër i ndotur, sëmundje, qytet, fshat.

“Morbidity and air pollution in Skopje region for year 2015”

M. Gjetaj – Jakovski¹, Sh. Musa¹, V. Dobrosavljevik¹, P. Simjanoski¹, Lj. Kostadinovski¹, R. Pejcinovska², L. Bajrami¹, L. Imeri¹/¹Center for Public Health – Skopje, R. Macedonia, ²Unemployed – Skopje, R. Macedonia

Introduction: It is estimated that 3 million people die annually due to air pollution, indicating the importance of daily concentrations of substances that are deposited in the ambient air, as a result of stationary and mobile sources of pollution that lead to the emergence of non-specific respiratory and cardiovascular diseases.

Goal: Reducing the number of infected pre-school and school aged children from non-specific respiratory diseases based on the monitoring of ambient air.

Materials and methods: The data are derived from the Annual Report that is being prepared for implementation of the National Annual Program for Public Health in year 2015 at the Centre for Public Health in Skopje, which follow seasonal morbidity from non-specific respiratory diseases in pre-school (0-6) and school aged (7-14) children, especially in towns and villages in the codes J00-J99 (non-specific respiratory diseases) except with J10-J18 (influenza and pneumonia), from the International classification of diseases (ICD-10).

Results: From the data evaluation it can be concluded that fewer children get infected in villages compared to the cities, as well as the existence of cyclical seasonal variations of morbidity.

Conclusions: Risk estimation of hygienic air quality on the health of exposed population in the case of preschool and school children, based on data obtained from the performed monitoring suggests a higher rate of air pollution in the city than in the countryside. It is essential to monitor the air quality continuously through continuous measurement of measuring points and sampling in order to determine the concentration of the polluting substances in the air.

Key words: Morbidity, Children, Air-pollution, Diseases, Cities, Villages